

VENDIME TË MIRATUARA NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, DATË 26 QERSHOR 2024
26 Qershor 2024
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 26 Qershor 2024:

VENDIM

PËR

AUTORIZIMIN E AUTORITETIT PORTUAL Durrës PËR TË NEGOCIUAR DREJTPËRDREJT DHE PËR TË LIDHUR MARRËVESHJE KONSULENCE ME SUBJEKT NDERKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr.16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Autorizimin e Autoritetit Portual Durrës për të negociuar drejtpërdrejt dhe për të lidhur marrëveshje konsulence me subjektin ndërkombëtar "Royal Haskoning DHV", brenda fushës së kompetencës së saj, një fushë me interes strategjik për proceset e konkurrimit, kontraktimit, ndërtimit dhe mbikëqyrjes së portit të ri të integruar të Durrësit në Porto Romano.
 - Ky autorizim qëndron në fuqi jo më shumë se 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e ligjit nr.16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020, "Për prokurimin publik".
 - Ngarkohet Autoriteti Portual Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA
